

Važna napomena: Prevod ovog propisa, odnosno akta sa srpskog jezika na albanski jezik, omogućila je Misija Organizacije za evropsku bezbednost i saradnju u Republici Srbiji (dalje: Misija OEBS u Srbiji) sa ciljem da se pripadnicima i pripadnicama nacionalne manjine, čiji je jezik u službenoj upotrebi u Republici Srbiji, omogući da se na svom jeziku i pismu obaveste i upoznaju sa sadržinom teksta propisa, odnosno akta koji je predmet ovog prevoda.

Misija OEBS u Srbiji posebno napominje da je isključivo i jedino pravno-relevantan i merodavan tekst propisa, odnosno akta (koji je predmet prevoda u ovom dokumentu) koji je objavljen na srpskom jeziku, u skladu sa i shodno propisu koji uređuje objavljivanje zakona i drugih propisa i akata u Republici Srbiji.

Za potrebe prevoda ovog propisa Misija OEBS u Srbiji angažovala je kompaniju Eurotranslate d.o.o. koja je u celosti, i u svemu prema pravilima struke, odgovorna i garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda na albanski jezik. Misija OEBS u Srbiji ni po jednom osnovu nije odgovorna i ne garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda.

Shënim i rëndësishëm: Përkthimin e kësaj dispozite, respektivisht akti nga gjuha serbe në gjuhën shqipe, e ka mundësuar Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejme: Misioni i OSBE-së në Serbi) me qëllim që pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës kombëtare, gjuha e të cilëve është në përdorimi zyrtar në Republikën e Serbisë, t'ua mundësojë që në gjuhën dhe shkrimin e tyre të informohen dhe të njihen me përmbajtjen e tekstit apo dokumentit, i cili është objekt i këtij përkthimi.

Misioni i OSBE-së në Serbi, në veçanti tërheq vërejtjen se teksti i rregullores, është ekskluzivisht teksti i vetëm ligjor-relevant dhe kompetent, respektivisht i aktit (i cili është objekt i përkthimit në këtë dokument), i cili është botuar në gjuhën serbe, në përputhje me dhe në pajtim me dispozitën që përcakton shpalljen e ligjit dhe dispozitave dhe akteve tjera në Republikën e Serbisë.

Për nevojat e përkthimit të kësaj dispozite, Misioni i OSBE-së në Serbi ka angazhuar kompaninë Eurocontract sh.p.k. e cila në tërësi, dhe sipas të gjitha rregullave të profesionit, është përgjegjëse për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë në gjuhën shqipe. Misioni i OSBE-së në Serbi për asnjë arsye nuk është përgjegjës dhe nuk garanton për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë.

Në mbështetje të nenit 62. paragrafi 1. pika 15) të Ligjit për Këshillat Kombëtare të pakicave kombëtare („Gazeta Zyrtare e RS”, nr. 72/09, 20/14 – vendimi i GJK dhe 55/14),

Komisioni republikan zgjedhor, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2014, miratoi

ORARIN

për kryerjen e aktiviteteve zgjedhore në procedurën e mbajtjes së zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarët e këshillave nacionale të pakicave kombëtare, të shpallura për 26 tetor 2014

"Gazeta Zyrtare e RS", numër 89 të datës 26 gusht 2014.

1. Afatet për ushtrimin e aktiviteteve zgjedhore në procedurën e zhvillimit të zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarë të Këshillave Nacionale të pakicave kombëtare, janë të përcaktuara:

– Me Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarë të Këshillave Nacionale të pakicave kombëtare („Gazeta Zyrtare e RS”, nr. 89/14)

– Me Vendimin për Këshillat Nacionale të pakicave kombëtare („Gazeta Zyrtare e RS”, nr. 72/09, 20/14 – vendimi i GJK dhe 55/14),

– Me Ligjin mbi zgjedhjen e deputetëve popullorë ("Gazeta Zyrtare e RS" nr. 35/00, 57/03 – vendimi i GJK, 72/03 – ligji shtetëror 18/04, 85/05 – ligji shtetëror, 101/05 – ligji shtetëror, 104/09 – ligji shtetëror, 28/11 - vendimi i GJK dhe 36/11),

– Me Udhëzimin për zhvillimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarë të Këshillave Nacionale të pakicave kombëtare, 02 numër 013-925/14, të datës 26 gusht 2014.

2. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të Këshillave Nacionale të pakicave nacionale ka hyrë në fuqi në ditën e publikimit, 26 gusht 2014.

Me vendim, zgjedhjet e drejtpërdrejta për anëtarë të Këshillave Nacionale të pakicave nacionale, janë shpallur për 26 tetor 2014.

Me vendim është përcaktuar, se afatet për ushtrimin e aktiviteteve zgjedhore fillojnë të ecin nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Sipas dispozitave nga pikat 1 e këtij orari, afatet janë si në vijim:

Nr. rendor	Aktiviteti	Afati
1. Formularët dhe rregullat		
1.1.	Përcaktimi dhe publikimi i formularëve dhe rregullave për realizimin e aktiviteteve zgjedhore (neni 62. paragrafi 1, pika 4) dhe paragrafi 2 i Ligjit për Këshillat Nacionale të pakicave nacionale – LpKNPN dhe neni 18 paragrafi 5 i Udhëzimeve)	më së voni der më 30 gusht në orën 24:00
2. Organet dhe trupat për realizimin e zgjedhjeve		
2.1.	Miratimi i vendimit për përcaktimin e numrit, përbërjes dhe sferës së punës së trupave punuese (neni 6 i Udhëzimeve)	më së voni më 25 shtator, në orën 24:00

2.2.	Paraqitja e propozimeve për anëtarë të trupave punuese (neni 7, paragrafi 1 i Udhëzimeve)	në afat prej pesë ditësh nga miratimi i vendimit nga pika 2.1.
2.3.	Formimi i trupave punuese (neni 7, paragrafi 3 i Udhëzimeve)	më së voni deri më 5 tetor në orën 24:00
2.4.	Paraqitja e propozimeve për anëtarët e komisioneve zgjedhore në Komisionin Zgjedhor Republikan (neni 10, paragrafi 1 i Udhëzimeve)	më së voni deri më 10 tetor në orën 24:00
2.5.	Formimi i komisioneve zgjedhore (neni 62, paragrafi 1, pika 6 dhe neni 65, paragrafi 3 i LpKNPN, neni 36, paragrafi 3 i Ligjit për zgjedhjen e deputetëve popullorë – LpZDP dhe neni 9, paragrafi 2 i Udhëzimeve)	më së voni deri më 15 tetor në orën 24:00
2.6.	Zëvendësimi i anëtarit të komisionit zgjedhor (neni 12 i Udhëzimeve)	më së voni deri më 20 tetor, në orën 24:00

3. Lista zgjedhore

3.1.	Paraqitja e listës zgjedhore (neni 76, paragrafi 1 i LpKNPN dhe neni 14 i Udhëzimeve)	deri më 10 tetor, në orën 24:00
3.2.	Shpallja e listës zgjedhore (neni 77, paragrafi 1 i LpKNPN dhe neni 20, paragrafi 1 i Udhëzimeve)	menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i marrjes së listës zgjedhore, nëse i plotëson kushtet
3.3.	Tërheqja e listës zgjedhore (neni 73. LpKNPN dhe neni 20, paragraf 3 i Udhëzimeve)	deri në ditën e përcaktimit të listës përmbledhëse zgjedhore, respektivisht më së voni 14 tetor, në orën 24:00
3.4.	Përcaktimi dhe publikimi i listës përmbledhëse zgjedhore në „Gazetën zyrtare të Republikës së Serbisë” (Neni 79, par. 1 dhe 4 i LpKNPN dhe neni 22, paragrafi 3 i Udhëzimeve)	15 tetor
3.5.	E drejta e shikimit në dokumentacionin, i cili është paraqitur me listën zgjedhore (neni 79, paragrafi 5 i LpKNPN)	në afat prej 48 orësh, nga dita e publikimit të listës përmbledhëse zgjedhore

4. Qendrat e votimit

4.1.	Paraqitja e të dhënave në Ministrinë e Drejtësisë për numrin e votuesve, që në ditën e zgjedhjeve do të gjenden në paraburgim ose në vuajtje të dënimit me burg (neni 24, paragrafi 3 i Udhëzimeve)	më së voni deri më 30 shtator, në orën 24:00
4.2.	Caktimi dhe publikimi i vendvotimeve në „Gazetën zyrtare të Republikës së Serbisë” (neni 62, paragrafi 1, pika 5 e LpKNPN dhe neni 24, paragrafi 1 i Udhëzimeve)	më së voni deri më 5 tetor në orën 24:00

5. Listat e veçanta zgjedhore		
5.1.	Regjistrimi dhe ndryshimet në listën e veçantë të votuesve nga ana e administratës komunale/apo të qytetit (Neni 48, paragrafi 3 LpKNPN dhe neni 27, paragrafi 1 i Udhëzimeve)	deri në përmbylljen e listës së veçantë zgjedhore, respektivisht më së voni 10 tetor
5.2.	Miratimin e Vendimit për përmbylljen e listave të posaçme zgjedhore të pakicave kombëtare (Neni 80, paragrafi 1 LpKNPN dhe Neni 28, paragrafi 1 i Udhëzimeve)	10 tetor
5.3.	Dorëzimin e Vendimit për përmbylljen e listave të veçanta zgjedhore në Komisionin Republikan Zgjedhor (Neni 80, paragrafi 3 LpKNPN dhe neni 28, paragrafi 3 i Udhëzimeve)	11 tetor
5.4.	Publikimin e Vendimit mbi përmbylljen e listave të posaçme zgjedhore në „Gazetën zyrtare të Republikës së Serbisë” (Neni 80, paragrafi 3 LpKNPN dhe neni 28, paragrafi 3 i Udhëzimeve)	11 tetor
5.5.	Dorëzimi në Komisionin Zgjedhor Republikan i deklaratave të vërtetuara nga listat e veçanta zgjedhore (Neni 80, paragrafi 6 LpKNPN dhe neni 29 i Udhëzimeve)	brenda 48 orëve, nga përmbyllja e listës së veçantë të votuesve, ose më së voni 12 tetor, në orën 24:00
5.6.	Regjistrimi dhe ndryshimet në listën e veçantë të votuesve nga ana e Ministrisë së Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale pas përmbylljes së listës së posaçme zgjedhore (Neni 57, paragrafi 1 LpKNPN dhe neni 27, paragrafi 2 i Udhëzimeve)	nga përmbyllja e listës së posaçme zgjedhore deri më 22 tetor, në orën 24:00
5.7.	Pranimi në Komisionin Zgjedhor Republikan të vendimeve të Ministrisë së Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale mbi të cilat mbështeten ndryshimet në listën e veçantë të votuesve, pas përmbylljes së listës së veçantë zgjedhore (Neni 80, par. 8 dhe 9 LpKNPN dhe neni 30, paragrafi 1 dhe neni 31, paragrafi 1 i Udhëzimeve)	deri më 23 tetor, në orën 24:00
5.8.	Përcaktimi dhe publikimi në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë” të numrit përfundimtar të zgjedhësve për çdo pakicë kombëtare (Neni 80, paragrafi 9 LpKNPN dhe Neni 32 i Udhëzimeve)	menjëherë pas skadimit të afatit për pranimin e vendimeve mbi të cilat mbështeten ndryshimet në listën e veçantë zgjedhore
6. Përfaqësuesit e propozuesve dhe vëzhguesit		
6.1.	Informimi i propozuesve të listës së shpallur zgjedhore mbi përfaqësuesit për monitorimin e punës së Komisionit Republikan Zgjedhor (Neni 45, paragrafi 8 i Udhëzimeve)	deri më 20 tetor
6.2.	Informimi i propozuesve të listës së shpallur zgjedhore mbi përfaqësuesit për monitorimin e punës së komisioneve zgjedhore	deri më 15 tetor

	(neni 45, paragrafi 9 i Udhëzimeve)	
6.3.	Paraqitja e kërkesës për monitorimin e punës për zhvillimin e zgjedhjeve – vëzhguesve vendorë (Neni 46, paragrafi 1 i Udhëzimeve)	deri më 20 tetor
6.4.	Paraqitja e kërkesës për monitorimin e punës së organeve për zhvillimin e zgjedhjeve, përkatësisht të punës së komisioneve zgjedhore – vëzhguesve të huaj (neni 47, paragrafi 1 dhe neni 48, paragrafi 1i Udhëzimeve)	deri më 15 tetor
7. Zhvillimi i zgjedhjeve		
7.1.	Dorëzimi i njoftimeve votuesve në lidhje me datën dhe kohën e zgjedhjeve (Neni 85, paragrafi 1 LpKNPN dhe Neni 33, paragrafi 2 i Udhëzimeve)	më së voni deri më 20 tetor
7.2.	Dorëzimi i materialit zgjedhor trupave punuese para votimit (Neni 36, paragrafi 3 i Udhëzimeve)	më së voni deri më 22 tetor, në orën 24:00
7.3.	Dorëzimi i materialit zgjedhor komisioneve zgjedhore (neni 90, paragrafi 8 i LpKNPN dhe 36, paragrafi 4 i udhëzimeve)	më së voni deri më 23 tetor, në orën 24:00
7.4.	„Heshtja parazgjedhore ” – ndalimi i propagandës zgjedhore (Neni 5, paragrafi 3 LpZDP)	nga 23 tetori në orën 24, deri në mbylljen e vendvotimeve më 26 tetor, në orën 20:00
7.5.	Hapja e vendvotimeve dhe e votimit (Neni 87, paragrafi 1 i LpZKNPN)	më 26 tetor, prej orës 7:00 deri në 20:00
8. Verifikimi dhe publikimi i rezultateve të zgjedhjeve		
8.1.	Dorëzimi i materialeve zgjedhore te Komisioni Zgjedhor Republikan nga vendvotimi pas votimit (Neni 97, LpKNPN)	më së voni deri më 27 tetor, në orën 8:00
8.2.	Verifikimi dhe publikimi i raporteve me rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve (Neni 97 i LpKNPN)	më së voni deri më 30 tetor, në orën 20:00
8.3.	Shikimi i materialeve zgjedhore në ambientet e Komisionit Zgjedhor Republikan (Neni 90, paragrafi 12 i LpKNPN)	më së voni deri më 31 tetor, në orën 24:00
9. Mbrojtja e të drejtës zgjedhore		
9.1.	Paraqitja e kundërshtimeve te Komisioni Zgjedhor Republikan (Neni 95 par. 1 dhe 3 i LpKNPN)	Në afat prej 24 orësh, nga momenti kur është miratuar vendimi, veprimi i kryer apo lëshimi i bërë
9.2.	Marrja e vendimit dhe dorëzimi i tij sipas ankesës	në afat prej 48 orësh, nga momenti i pranimit të

	(Neni 96, paragrafi 1 i LpZDP)	ankesës
9.3.	Ankesë në Gjykatën Administrative kundër vendimit të Komisionit Republikan Zgjedhor (Neni 97, par. 1 dhe 2 i LpZDP)	në afat prej 48 orësh, nga pranimi i ankesës
9.4.	Dorëzimi i kundërshtimeve në dokumentet e Gjykatës Administrative (Neni 97, paragrafi 3 i LpZDP)	në afat prej 24 orësh, nga pranimi i ankesës
9.5.	Sjellja e vendimit sipas ankesës (Neni 97, paragrafi 5 i LpZDP)	në afat prej 48 orësh, nga pranimi i ankesës
10. Ndarja e mandateve dhe dhënia e certifikatave mbi zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Kombëtar		
10.1.	Miratimin e vendimit për ndarjen e mandateve të anëtarëve të Këshillit Kombëtar (Neni 98, paragrafi 8 i LpKNPN)	në afat prej tri ditësh, nga dita e verifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve
10.2.	Dorëzimi i vendimeve mbi ndarjen e mandateve të anëtarëve të këshillit kombëtar Ministrisë së Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale dhe publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë”	menjëherë pas miratimit të vendimit
10.3.	Lëshimi i certifikatave mbi zgjedhjen për anëtar të Këshillit Kombëtar (Neni 98, paragrafi 12 i LpKNPN)	menjëherë pas caktimit të mandateve, përveç nëse nuk ekziston kontest administrativ

4. Ky orar të botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë”.

02 numër 013-926/14
Në Beograd, 26 gusht 2014
Komisioni Zgjedhor Republikan
Zëvendëskryetari,
Ivan Šebek, d.v.